KËRKESË
Nr. 2991/6, datë 28.5.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit "Ndërtimi i ishullit në lumin Osum".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Berat. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vënë në dijeni persona të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP", do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 37.821.663 (tridhjetë e shtatë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani

TABELA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN QE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "Ndërtimi i ishullit në lumin Osum".

Nr	Pronari		Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Siperfaqia		Çmimi		Vlera		Shenime
					Truall	Ndertim	Truall	Ndertim	Truall	Ndertim	
	Emri	Mbiemri			m2	m2	lek	lek	lek	lek	
1	Kujtim	Bega	8502	11/4		773				37.821.663	Konfirmuar nga Z.V.R.P.P
	Shuma								-	-	
VLERA TOTALE										37.821.663	Leke